



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1016 / Prot.
3

Patos, më 21/04/2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 21 PRILL 2026

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjesë publike me temë: “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”.

Pjesëmarrës: Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme e bashkisë Patos, znj. Juela Shpata, Drejtore e Financave znj. Mimoza Shtëmbari, Anëtarë GMS, përfaqësues të bashkisë Patos, me pjesëmarrjen e **43 pjesëmarrësve** (banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave etj)

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

pjesë të kësaj dëgjese publike. Tema e kësaj dëgjese është “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”. Kjo dëgjese është e bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”. Jemi në hapat e parë të procedurës për hartimin e PBA-së. Është e nevojshme dhe e domosdoshme të bashkëpunojmë me qytetarët në lidhje me kërkesat apo probleme të ndryshme që ka në territorin e bashisë tonë, me qëllim që materiali përfundimtar të jetë i plotë. Do ju lutesha që fjala të merrej me rradhë dhe të prezantoheshit gjatë kërkesave tuaja. Ju faleminderit!

Drejtores e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– Përshëndetje të gjithëve! Jemi në fazën që po marrin të gjitha kërkesat e qytetarëve sipas grupeve të interesit. Gjatë gjithë fazës së



**Drejtores e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

hartimit kjo do të jetë faza e parë që ne marrim kërkesat dhe më pas do të kemi edhe fazat e rishqyrtimit të dokumentit të buxhetit deri në hartimin e dokumentave përfundimtar të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027.

Banor i lagjes së Re, z. Panajot Levendi- Përshëndetje! Unë kam një kërkesë për qendrën e qytetit pasi është bërë shumë problem rruga kryesore për kalimtarët, për parkimin dhe të moshuarit. Nëse zgjerohet si rrugë dhe investohet për diçka më të mirë do të ishte një zgjidhje për qytetarët. Edhe shatërvani i vogël që ndodhet në qendër nuk punon dhe duhet të vendoset në funksion.



**Banor i lagjes Re
z. Panajot Levendi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Banor i lagjes Re Patos, z. Alfred Agaraj – Përshëndetje! Unë jetoj në lagjen e Re Vreshti dhe më mungojnë 10 m asfalt të cilën nuk ma kanë shtruar. Gjithashtu nuk kam as linjë ujësjellsi të lidhur. Makina nuk futet në atë rrugë dhe është edhe një pusetë që është problem. Bëhet fjalë për pjesën fundore të rrugës së Vreshtit.



**Banor i Vreshtit
z. Alfred Agaraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Banor i lagjes Re, z. Shezai Harunaj- Përshëndetje! Në lagjen tonë janë bërë shumë punime, por pranë bancës time nuk janë bërë as kanalizime, as rruga nuk është shtruar 70 m. Unë i paguaj taksat dhe kërkoj të marr dhe shërbim. Gjithashtu kam edhe një problem me



**Banor i lagjes Re
z. Shezai Harunaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

devijimin e hartës pasi kanë ndryshuar hartën dhe kanë devijuar rrugën. Është objekti ku është qendra shëndetësore dhe unë nuk kaloj dot aty. Gjithashtu nuk kemi as ndriçim. Kam bërë kërkesa edhe në bashkinë Patos.

Drejtoresha e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile, znj. Boreta Murati- Problemin e devijimit të hartës ne e kemi adresuar kundrejt hipotekës dhe kjo është kompetencë e tyre. Lidhur me pjesën e asfaltimit të rrugës do ta shikojmë në investimet afatmesme që të ndërhyjmë për sistemimin e saj. KUZ është detyrë funksionale e ujësjellësit.



**Drejtoresha e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile
znj. Boreta Murati**

Dëgjesë publike me temë:

“Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”.

Prill 2026

Kryetar i fshatit Margëlliç, z. Agron Faslliaj- Unë dua të falenderoj Agjencinë e Shërbimeve Publike për punët e bëra deri tani në Margëlliç. Jam bërë hapje rruge, spërkatje pemësh, pastrime etj.



**Kryetar i fshatit Margëlliç
z. Agron Faslliaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029”.

Prill 2026

Banues në lagjen “1 Maj”, z. Kudret Rrapushaj- Përshëndetje! Unë kam bërë një kërkesë për rikonstrukcion banese pasi objekti im është i vitit 1948 dhe në gjendje të rënduar. Unë nuk bëj dot rikonstrukcion të banesës time.



**Banues në lagjen “1 Maj”
z. Kudret Rrapushaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Banues në Rrerës, z. Përparim Xhelaj- Unë kam një ankeë për tokën time bujqësore në



**Banues në Rrerës
z. Përparim Xhelaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Rrerës pasi në tokën time ka ngelur gjysëm kanali ujërave të zeza pa tubacion dhe duhet vendosur tubacion dhe të mbyllet si kanal.

Banor i fshatit Dukas Kripallarë, z. Safet Saliaj- Përshëndetje! Unë kam një kërkesë në emër të gjithë banorëve. Ne kërkojmë të ndërtohet një treg ushqimor ku të tregtohen



**Banor i fshatit Dukas Kripallarë
z. Safet Saliaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

produktet ushqimore. Kisha edhe një kërkesë lidhur me rrugën tonë e cila ka filluar me

rikonstrukcionin e saj. Kërkoj të vendoset edhe ndriçimi në rrugën e Kripallarëve dhe kosha mbeturinash.

Sekretare e Përgjithshme, znj. Juela Shpata- Për sa i përket krijimit të një tregu ushqimor, është pjesë e projektit që po zbatohet në lagjen “1 Maj” dhe përfshin edhe krijimin e tregut me të gjitha standardet për tregtimin e produkteve ushqimore dhe do të përfundoj brenda këtij viti.



**Sekretare e Përgjithshme
znj. Juela Shpata**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Drejtoreshë e Emergjencave Civile dhe Zhvillimit të Territorit, znj. Boreta Murati- Për sa i



**Drejtoreshë e Emergjencave Civile dhe
Zhvillimit të Territorit
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

përker linjës së ndriçimit në rrugën e Kripallarëve nuk është parashikuar një linjë e re ndriçimi pasi ka aktualisht një linjë ndriçimi. Nëse është e nevojshme për ndërhyrje në ndriçim do e parashikojmë me ASHP. Koshat do të mund ti shtojmë në lagjen tuaj.

Përfaqësues i shoqatës së Pensionistëve, z. Bashkim Velçani- Shoqata jonë ka nevojë për ndërhyrje dhe ndihmë në materiale. Gjithashtu qytetarët kanë probleme me procesin e legalizimit. Kur do kryhet procesi i legalizimit në bashki? Gjithashtu është thënë që do të krijohen administratorët e pallateve dhe ende nuk janë zgjedhur. Kur do të zgjidhen?



**Përfaqësues i shoqatës së Pensionistëve
z. Bashkim Velçani**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Banor i lagjes “1 Maj”, z. Tajar Hysenaj- Unë kam një kërkesë për rikonstruksionin e çatisë së shtëpisë pasi më pikon uji në banesë.



**Banor i lagjes “1 Maj”
z. Tajar Hysenaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Banor i lagjes “1 Maj”, z. Emiljano Hajdëraj- Edhe unë kam një kërkesë për rikonstruksionin e çatisë së shtëpisë pasi më pikon uji në banesë. Jam dhe invalid nuk e rikonstruktoj dot vet.



**Banor i lagjes “1 Maj”
z. Emiljano Hajdëraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Kryetar i fshatit Kuqar, z. Islam Shpata- Përshëndetje! Dua të falenderoj bashkinë për të gjitha punët sidomos për hapjen e rrugëve të parcelave. Në Rusinjë është një rrugë rreth 300

m për tu shtruar. Gjithashtu te shkolla "Hekuran Maneku" përballë, te lagjja "1 Maj" është 200 m rrugë për tu shtruar.



**Kryetar i fshatit Kuçari
z. Islam Shpata**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029".**

Prill 2026

Kryetar i fshatit Rrerës, z. Shaban Ruçaj- Është bërë një punë e mirë, por kanë ngelur pa



**Kryetar i fshatit Rrerës
z. Shaban Ruçaj**

**Dëgjesë publike me temë:
"Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029".**

Prill 2026

bërë disa gjëra të rëndësishme. Kam ngritur më parë një problem të KUZ të Karamanaj dhe në seksion është mbyllur. Seksioni tjetër në anën tjetër ka ngelur pa u mbyllur nga ujësjells. Ata janë vendosur në dijeni lidhur me këtë seksion pasi janë në mes të lagjes Karamanaj dhe Biçakaj. Aty ka nevojë për vendosjen e tubove, por kanë nevojë nga ana e bashkisë të dërgoj skrepin për hapjen e ferrave dhe kanaleve. Gjithashtu në Rerës ka ndriçim mangët. Rruga e re që u bë Karamanaj nuk ka ndriçim. Rrugët e parcelave u hapën, por na dalin problem tani nga banorët sepse thonë që rruga na kalon mes të ullinjve dhe nuk bien dakord, prandaj kanë ngelur pa mbyllur. Te Rrapushajt kishte filluar rruga. Kjo ka sjell konflikte me njerëzit. Te blloku i Shahinit që është pjesë e rrugëve të parcelave të Rrapushajve, është hapur si rrugë dhe u planifikua për çakëll. Janë mbi 70 fermerë në atë gropë dhe e aksesojnë, prandaj ka nevojë për çakëll dhe pastrim. Rruga Buzaj është pa ndriçim, është prishur dhe te pjesa e varrezave. Rruga Zekallarët është për tu shtruar. Kukallarët nuk është shtruar. Gjithashtu ndriçimi në rrugën Çobaj mungon, nuk ndizet.

Banor i lagjes së Re, z. Ferdinand Topi- Unë kam një problem te banesa ime pasi më kanë vendosur një kondicioner fqinji dhe uji i tij më pikon në dritare. Gjithashtu kemi problem dhe me parkimin e makinave.



**Banor i lagjes së Re
z. Ferdinand Topi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Artan Velçani- Dëgjova me vëmendje që bashkia është në këtë dëgjesë për nevoja për të planifikuar buxhetin për vitin e ardhshëm dhe prioritetet e tij. Nuk heq asnjë pikë nga ato që thanë parafolësit që nga ajo për rivlerësimin e rrugës kryesore dhe qendrës së qytetit dhe ndërhyrjet në të. Theksoj që janë bërë shumë punë të mira krahasuar me më para. Dua të theksoj dy prioritete shumë të mëdha për qytetin tonë, që është rruga nga bashkia deri në lagjen “Mustafa Matohiti” dhe prej aty është një rrugë tjetër që fillon nga qafa e Patosit Lart dhe zbret në Oficinë dhe është në gjendje të keqe. Unë do i mëshoja një fakti shumë thelbësor për administratën. Ne jemi një familje dhe duhet të përpiqemi të zgjidhim çështjet e pronave dhe shqetësimet që kanë qytetarët për Kadastrën. Le të krijohet një zyrë e veçantë për këto probleme.



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Artan Velçani**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

është duke bashkëpunuar me aq sa ka mundësi dhe duke referuar problemet e qytetarëve. Ende nuk është krijuar zyra brenda bashkisë për të koordinuar punët me ASHK Fier.

Banor i lagjes së Re , z. Vladimir Shusha- Unë ka një problem lidhur me qarkullimin e mjeteve në orët e vona tej normave të lejuara. Ky është një problem i madhe që po shqetëson komunitetin tonë. Ky problem duhet deleguar në polici dhe duhet zgjidhur. Xhirohet në orët e vona me shpejtësi marramendëse.



**Banor i lagjes së Re
z. Vladimir Shusha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Unë i bashkohem shqetësimit tënd dhe Policia është njoftuar lidhur me këto probleme. Nuk janë marr masa akoma lidhur me zgjidhjen e këtij problemi që mund të krijoj fatkeqsi në qytet. Kërkojmë të mërren masa lidhur me këtë problem.

Përfaqësues e Stacionit të Policisë Patos, z. Asllan Budaj – Lidhur me shqetësimin e qytetarit, policia ka punuar dhe vazhdon të punoj lidhur me këto raste dhe me rendin dhe qetësin e qytetit, por ka një moment që ne kemi gati 18 muaj që nuk kemi shërbime të patrullës, pasi jemi duke ruajtur dikë në arrest shtëpie dhe nuk kemi punonjës patrulle. Jemi përpjekur edhe me gjoba kundrejt këtyre problemeve, por nuk kemi shërbime.



**Përfaqësues i Policisë Patos
z. Asllan Budaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Banore e lagjes “Naftëtari”, znj. Rudina Brahimaj- Unë kam bërë një kërkesë në emër të prindërve që janë të moshuar. Ata kanë një banesë në gjendje të rënduar, por nuk kam marrë një përgjigje për zgjidhjen e situatës së tyre. Emri i babait tim është Nazar Brahimaj.



**Banore e lagjes “Naftëtari”
znj. Rudina Brahimaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Banore e lagjes “1 Maj” , znj. Kleida Hoxha- Unë kam bërë një kërkesë për varrezat e



**Banore e lagjes “1 Maj”
znj. Kleida Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.
Prill 2026**

Hoxhallarëve në Kuqar duke qënë se jam bijë në Kuqar. Punime janë bërë dhe në varrezat e tjera, por në varrezat e Hoxhallarëve nuk po bëhet asnjë lloj ndërhyrje, ndaj kërkoj ndërhyrje. Kam bërë edhe një kërkesë si qytetarë për shtëpinë në Kuqar, pasi nga rreshjet ka shkarë dhe dhe më ka dëmtuar banesën dhe dua të kërkoj një mur mbajtës në mënyrë që mos të dëmtohet banesa ime. Në pamundësi për ta bërë vet kërkoj ndihmë nga bashkia për vendosjen e murit mbajtës.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse nuk kemi kërkesa të tjera e deklaroj të mbyllur këtë dëgjese publike. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2027-2029”.**

Prill 2026

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba